



SAMBAL

“Bali Aura” shpk, e ka filluar aktivitetin në Shkurt të vitit 2018 dhe aktiviteti i saj kryesor është prodhimi dhe shpërndarja me shumicë e ushqimeve autentike, Aziatike, “SAMBAL”.

Marka “Sambal” është e mbrojtur dhe ekskluzive, dhe të gjithë produktet janë të aprovuara nga Autoritetet Shtetërore kompetente.

PRODUKTET

Authentic Asian Egg Noodles (makarona Aziatike me vezë), në sasinë 500g, me 3 erëza të shtuara dhe ambalazh letre të riciklueshëm.



Instant Noodles (makarona Aziatike të çastit), me 3 shije; Pule, Viçi dhe Perimesh. Për 3 minuta janë gati për t'u konsumuar, duke shtuar gjithë përmbajtjen e qeskës në ujë të vluar. Sasia është 106g "BIG PACK".



Sweet Chili Sauce (salcë e ëmbël pikante) në sasinë 330ml. Përdoret për shoqërimin dhe gatimin e ushqimeve të ndryshme Aziatike. Me ambalazh qelqi.



PRODHIMI

Kompania jonë është e vetmja në Shqipëri, që prodhon ushqime Aziatike.

Reputacioni që gëzojmë në treg, vjen si rrjedhojë e besnikërisë ndaj klientëve dhe qëndrueshmërisë së cilësisë, si dhe specifikave të produkteve, vecanerisht: Prodhimit me metoda e formula të shëndetshme (pa skuqje dhe konservantë e aditivë të tjerë) dhe freskisë, gjë që ka sjellë rritjen e shitjeve dhe shtimin e gamës së produkteve. Për arsye se Kompania ka avantazhin e prodhimit sipas nevojave të tregut, përdorimi i konservantëve kimike nuk është i nevojshëm dhe produktet tona në markete gjenden gjithnjë të freskëta. Për ruajtje sa më mirë të tyre, ne përdorim vetëm substanca natyrale si; uthull, limon dhe pluhur hudhre.

Të gjithë elementët e përmendur më sipër, përbëjnë avantazh për kundërt të njëjtëve produkte të importuara që qarkullojnë në treg, të cilat, përveç çmimit më të lartë në raport me cilësinë dhe sasinë, për efekt jetëgjatësie në raft përmbajnë mjaft konservantë dhe aditivë, dhe janë shpesh jo të freskëta për shkak të kohëzgjatjes së procedurave të transportit dhe importit.

Pajisjet e prodhimit si: Makineri prodhimi për noodles me kapacitet prodhimi 340kg/orë, pajisje dehidratimi, avulli etj, janë unike dhe të standardve të larta, të sjella nga Azia.

Gjithashtu, prodhimi realizohet nga staf i kualifikuar në prodhimin ushqimor, trainuar specifikisht për produktet Aziatike.



Shitjet

Produktet tona kanë hyrë suksesshëm në treg, pavarësisht konkurrencës së firmave të fuqishme. Ato gjenden në gjithë zinxhirët më të rëndësishëm të supermarketeve në të gjithë Shqipërinë, në 220 pika shitje, dhe ka një tendencë të vazhdueshme të rritjes së kërkesës së tyre pasi, kryesisht fëmijët, të rinjtë dhe moshë e mesme, janë mjaft të familjarizuar dhe përdorues të rregullt të ushqimeve Aziatike. Shitja dhe shpërndarja e tyre realizohet nga stafi i shitjeve, me mjetet e Kompanisë.

